



Rr. 'Luigj Gurakuqi', P15/1, Sh.1, Ap.1
PO Box 218/1, Tirana
Tel./Fax (04) 230 445
Mobile: 069 22 40 906
E-mail: info@qkzh.org
www.qkzh.org

Vlerësimi i transparencës në arsimin e lartë

Me mbështetje të:

Fondacionit Soros, Tiranë

Përmbajtja e lëndës

Kapitulli I: Objektivat dhe metodologjia e raportit

- 1.1 Objektivat dhe qëllimi i raportit*
- 1.2 Metodologjia*

Kapitulli II: Vlerësim i transparencës dhe performancës në arsimin e lartë

- 2.1 Zbatimi i rregullave të pranimit në fakultet*
- 2.2 Zbatimi i procedurave të provimit të pranimit në fakultet*
- 2.3 Mbi punën e komisionit të vlerësimit të provimit të pranimit*
- 2.4 Pranimet jashtë listës së shpallur të provimit të pranimit*
- 2.5 Pagesa për tu rregjistruar jo konform rregullave në fakultet*
- 2.6 Procedura e sigurimit të hyrjes nga pedagogu në provim*
- 2.7 Mënyra për të eliminuar mungesat në rast se një student ka më tepër nga sa parashikohet në rregullore*
- 2.8 Dhënia e provimit pas datës së fiksuar*
- 2.9 Mënyra e zgjedhur për të kaluar provimet*
- 2.10 Pagesa mesatare për të kaluar provimin*
- 2.11 Faktorët nga të cilët varet pagesa për të kaluar provimin*
- 2.12 Mesatarja e pedagogëve që imponojnë blerjen e librit të tij sipas Universiteteve*
- 2.13 Sa të gatshëm janë studentët për të paguar për fakultetin që duan*
- 2.14 Studentë që janë kërkuar direkt apo indirekt (seksualisht) nga pedagogu për të kaluar provimin*
- 2.15 Dhurata apo favore që kërkojnë pedagogët nga prindërit e studentëve*
- 2.16 Mënyra e sigurimit të dhomës në konvikt*
- 2.17 A kanë privilegje studentët e zgjedhur në forumet e fakultetit*
- 2.18 Perceptimi i korrupsionit për pedagogët dhe dekanatin*
- 2.19 Shkalla e informacionit të studentëve mbi forumet studentore*
- 2.20 Niveli i informimit që kanë studentët lidhur me hedhjen në gjyq ose jo të institucionit shkollor ose pedagogut*
- 2.21 Mënyrat e minimizimit të korrupsionit*
- 2.22 Ndikimi i pagave të pedagogëve në nivelin e korrupsionit*
- 2.23 Shpërndarja në përqindje e studentëve sipas idhullit që ata kanë*

Kapitulli III: Konkluzione

Kapitulli I

Objektivat dhe Metodologjia e Raportit

1.1 Objektivat dhe qëllimi i raportit

Me anë të këtij projekti u synua të bëhet një vlerësim në lidhje me transparencën në arsimin e lartë. Qëllimi i këtij studimi është të ndihmojë në përmirësimin e punës së pedagogëve, raportit student - pedagog dhe rritjes së cilesisë dhe nivelit shkencor të universitetit shqiptar sot. U synua sigurisht, që publiku dhe lobet e ndryshme të interesuara për transparencën në arsimin e lartë të kuptojnë se cila është masa e korrupsionit dhe së dyti, të krijohet një tablo e saktë mbi zbatimin ose jo të të gjitha procedurave dhe rregullave që sigurojnë mbarëvajtjen e punës në Universitete. Studimi do të shërbejë gjithashtu për të ndërtuar politika të drejta gjithmonë në funksion të minimizimit të korrupsionit në auditoret studentore. Ky studim është ndërtuar mbi bazën e një metodologjie të përshtshme. Studime të tilla të ngjashme janë bërë dhe në vende të tjera të rajonit.

Në mënyrë të përmbledhur me anë të këtij studimi u synua realizimi i objektivave të mëposhtme:

1. U përgatit një metodologji e pranueshme mbi mënyrën e llogaritjes së indikatorëve mbi vlerësimin dhe performancën në universitete.
2. U bë vlerësimi i transparencës në arsimin e lartë në universitetet kryesore të vendit, si dhe sipas fakulteteve.
3. U formuluan rekomandime të vecanta në drejtim të minimizimit të korrupsionit dhe në drejtim të përmirësimit të procedurave të pranimit dhe rregullave të zbatuara në arsimin e lartë.
4. U synua nxitja e debatit publik në lidhje me mbështetjen dhe transparencën e arsimit të lartë në Shqipëri, nëpërmjet publikimit të të dhënave të këtij studimi.

1.2 Metodologjia

Ky studim në lidhje me çështjet e transparencës dhe performancës së universiteteve të Shqipërisë është bazuar në metodologjinë e kontaktit të drejtpërdrejtë dhe tërheqjes së opininit të studentëve në lidhje me çështje të ndryshme tepër të rëndësishme. Nga pikëpamja statistikore për të qenë sa më reprezentativ, në këtë studim janë marrë në konsideratë Universiteti i Tiranës, Politeknik, Bujqësor, Akademia e Arteve si dhe universitetet në rrethet më kryesore të vendit : Elbasan, Shkoder Vlorë, ku janë kontaktuar mbi 1300 studentë nga të cilët 1027 prej tyre i janë përgjigjur pyetësorit. Studentët e intervistuar janë të degëve si Ekonomik, Mjekësi, Inxhinieri, Histori- Filologji, Juridik, Shkenca Sociale, Arte, etj dhe gjinisë të ndryshme nga ku rezulton se 74% e të anketuarve janë femra dhe 26% meshkuj. Duke synuar të japim një pamje të përgjithshme të gjëndjes aktuale të Universiteteve në Shqipëri u realizua një analizë e detajuar e indikatorëve që do të trajtohen në kapitullin në

vazhdim, këto në shërbim të rritjes së efektivitetit në zbatimin e procedurave për arsimin e lartë.

Kapitulli II


Vlerësimi i transparencës dhe performancës në arsimin e lartë

2.1 Zbatimi i rregullave të pranimit në fakultet.

Në këtë nënçështje do të trajtohet në mënyrë vlerësuese opinioni i studentëve mbi zbatimin e rregullave të pranimit në fakultet.

Nga totali i studentëve të intervistuar (shiko figurën 1), 68% e tyre mendojnë se ka zbatim të rregullave dhe 30% e totalit mendon se këto rregulla shkelen. Kjo shifër shpreh shkallën e ulët të zbatimit të rregullave në përgjithësi në universitetet tona si dhe besimin e ulët të studentëve në lidhje me këtë çështje.

Duke vlerësuar përgjigjet për çdo universitet, rezulton se në Universitetin e Elbasanit vetëm 57% e studentëve mendojnë se zbatohen rregullat ndërkohë që është dhe shifra më e ulët e vlerësuar, e pasuar kjo dhe nga mosbesimi në Universitetin Bujqësor me 61% të të intervistuarve dhe atë të Vlorës me vetëm 64%.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Refuzon përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	72	27	1
II. Universiteti Politeknik	62	37	2
III. Univeriteti Bujqësor	61	39	0
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	67	33	0
V. Universiteti i Elbasanit	57	40	3
VI. Universiteti i Shkodrës	83	16	1
VII. Universiteti i Vlorës	64	34	2
TOTALI	68	30	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.2 Zbatimi i procedurave të provimit të pranimit në fakultet.

Nga figura 2 e mëposhtme që pasqyron në mënyrë grafike zbatimin e procedurave të provimit të pranimit vetëm 36% e të anketuarve pohojnë se procedurat e pranimit janë të rregullta, shifër kjo relativisht e ulët dhe që për pasojë lë të kuptohet se procedurat shkelen dhe nuk janë të rregullta në mënyrë masive. Për këtë çështje vlen të theksohet se rreth 38% e studentëve japin një përgjigje evazive që tregon se ata nuk dinë të përgjigjen kundrejt kësaj pyetje. Kjo tregon që transparenca në Universitetet e intervistuar është në shkallë të ulët si dhe informacioni që studentët arrijnë të marrin pothuajse nuk ekziston.

Nga tabela 2 shikohet se mbi mesataren e përgjigjur pozitivisht për këtë pyetje qëndron Universiteti i Shkodrës dhe i Tiranës ndërsa me përgjigje më negative rezultojnë Universiteti i Elbasanit dhe ai Bujqësor me përkatësisht 23 dhe 32 % e të intervistuarve.




Në % ndaj totalit	Konform rregullave	Janë shkelur rregullat	Nuk e di
I. Universiteti i Tiranës	40	24	36
II. Universiteti Politeknik	31	23	46
III. Univeriteti Bujqësor	32	33	36
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	31	31	38
V. Universiteti i Elbasanit	23	34	43
VI. Universiteti i Shkodrës	41	14	45
VII. Universiteti i Vlorës	38	30	33
TOTALI	36	26	38

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.3 Mbi punën e komisionit të vlerësimit të provimit të pranimit.

Për këtë pyetje 45 % e studentëve universitarë mendon se ka manipulime dhe 22 % mendojnë se nuk ka manipulime, ndërsa 33% hezitojnë të përgjigjen. Nga kjo del qartë se komisionet e provimit janë në të gjitha pikpamjet teknike, profesionale e morale tepër të dobëta. Refuzimi i kësaj pyetje nga 33% e studentëve kur vetëm 22% janë të bindur se komisioni punon ndershmërisht e tregon qartë performancën e këtyre komisioneve. Por njëkohësisht këtu evidentohet dhe një aspekt tjetër se studentët nuk janë të lirë plotësisht të shprehin për komisionin, thënë kjo nga 33% e të intervistuarve që hezitojnë përgjigjen.

Vihet re se në Universitetin e Elbasanit mbi 62% e studentëve pohojnë se ka manipulime, po këtë gjë e pranon shumica e studentëve në Universitetin Politeknik me 58%, dhe Akademinë e Arteve me 51% e të intervistuarve. Universiteti i Shkodrës shënon shifrën më të ulët me 33 % të të intervistuarve, që mendojnë dhe besojnë në zbatimin jo korrekt të punës së komisionit të vlerësimit të provimit të pranimit.




Në % ndaj totalit	Ka manipulime	Nuk ka manipulime	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	40	25	35
II. Universiteti Politeknik	58	18	23
III. Univeriteti Bujqësor	46	25	29
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	51	20	30
V. Universiteti i Elbasanit	62	6	32
VI. Universiteti i Shkodrës	33	30	37
VII. Universiteti i Vlorës	45	18	37
TOTALI	45	22	33

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.4 Pranimet jashtë listës së shpallur të provimit të pranimit

Në lidhje me këtë pyetje 51 % e studentëve pohojnë faktin se ka patur pranime jashtë listave të shpallura zyrtarisht. Rreth 39 % e studentëve pretendojnë se nuk dinë gjë për këtë fakt ose nuk janë të informuar. Vetëm 10 % e të intervistuarve sigurojnë se nuk ka patur asnjë pranim jashtë listës së shpallur të provimit duke besuar në drejtësinë e procedurave pranuese.

Tabela 4 bën një paraqitje në nivel Universitësh mbi pranimet jashtë listës së provimit. Universitetet që e pohojnë masivisht këtë fakt janë: Universiteti Politeknik me 66% të studentëve, i Elbasanit me 60%, Tiranës me 52%. Të bie në sy vlera prej 23% e studentëve të Institutit të Fiskulturës që e pohojnë këtë fakt duke shënuar dhe shkallën më të lartë të transparencës për këtë çështje, kundrejt 25% të atyre që e mohojnë këtë fakt dhe 52% e studentëve që hezitojnë përgjigje.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Nuk e di
I. Universiteti i Tiranës	52	5	42
II. Universiteti Politeknik	66	6	28
III. Univeriteti Bujqësor	53	14	32
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	23	25	52
V.Universiteti i Elbasanit	60	1	38
VI.Universiteti i Shkodrës	36	31	33
VII.Universiteti i Vlorës	54	12	34
TOTALI	51	10	39

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.5 Paguesa për tu regjistruar jo konform rregullave në fakultet

Nga figura e mëposhtme shikohet se 66 % e studentëve të intervistuar mendojnë se nuk kane njohuri mbi shumën e parave që paguhet për një regjistrim në fakultet, ndërsa 13 % e studentëve janë në gjëndje të thonë shumën e saktë që paguhet për regjistrim dhe rreth 18 % heziton të përgjigjet për këtë pyetje. Pra pagesa jo konform rregullave në regjistrim është një fakt i pakontestueshëm dhe i përmëndur nga një numër jo i vogël të intervistuarish që nuk hezitojnë të japin shumën që është paguar. Duke analizuar më në detaje përgjigjet e studentëve të cilët e dinë sa është paguar në regjistrim vërehet se për të hyrë në Unversitetin e Tiranës paguhet afërsisht 2,5 herë më shumë se për të hyrë në Universitetet në rrethet e vendit, gjithashtu kjo shifër është më e madhe se sa pagesa për Universitetet e tjera të Tiranës. Mesatarisht kjo shumë për UT është 456 000 lekë. Për Akademinë e Arteve, Tiranë është 310 000 lek, Universitetin Politeknik është 264 000 lekë dhe për Bujqësorin 115 000 lekë. Shuma e paguar për t'u regjistruar jo konform rregullave në Universitetet në rrethe është 184 240 lekë për Universitetin e Elbasanit i ndjekur nga Universiteti i Shkodrës dhe ai i Vlorës.



Në % ndaj totalit	Nuk e di	E di shumën	Refuzon përgjigjen
I. Universiteti i Tiranës	71	12	17
II. Universiteti Politeknik	71	8	22
III. Univeriteti Bujqësor	80	4	16
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	54	21	25
V. Universiteti i Elbasanit	57	21	22
VI. Universiteti i Shkodrës	67	14	20
VII. Universiteti i Vlorës	72	11	17
TOTALI	69	13	18


Universitetet	Paguar mesatarisht në Lekë
I. Universiteti i Tiranës	456148
II. Universiteti Politeknik	264000
III. Univeriteti Bujqësor	115000
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	310385
V. Universiteti i Elbasanit	184240
VI. Universiteti i Shkodrës	163400
VII. Universiteti i Vlorës	122000

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.6 Proçedura e sigurimit të hyrjes nga pedagogu në provim.

Rreth 81 % e studentëve janë të bindur se do të hyjnë në provim konform rregullave, vetëm 19 % e tyre kanë nevojë për ndërmjetësim ose të paguajnë para për të shkelur rregullin. Prapë kjo shifër megjithëse përfaqësohet nga një numër i vogël i të intervistuarve lë të kuptohet që ligji, zbatohet i segmentuar në Universitete.

Nëse do të bënin një analizë në nivel universitetesh (tabela 6) do të shikonim se rreth 26% e studentëve të Institutit të Arteve, 27% e studentëve të Universitetit Bujqësor, 29% e studentëve të Universitetit të Elbasanit mendojnë të paguajnë ose të ndërmjetësojnë për të hyrë në provime. Në Universitetin e Tiranës kjo shifër është tepër e ulët me vetëm 11% dhe mbi 88% e studentëve të këtij universiteti mendojnë të futen në provim konform rregullave. Nëse do të bënin një krahasim të dy nënçështjeve të fundit midis atyre studentëve që përmendin shumën e paguar jo konform rregullave për të hyrë në fakultet dhe studentëve që paguajnë ose përdorin ndërmjetësimin për të hyrë në provim shifrat do të na përfaqësonin shumë (vlerat janë përkatësisht 13 dhe 19% e studentëve). Kjo situatë na bën të mendojmë se i njëjti kontigjent studentësh i regjistruar jo konform rregullave vazhdon të sigurojë hyrjen në provim në të njëjtën mënyrë, duke paguar ose me ndërmjetësim.




Në % ndaj totalit	Konform rregullave	Duke paguar	Me miqësi
I. Universiteti i Tiranës	88	5	6
II. Universiteti Politeknik	78	14	8
III. Univeriteti Bujqësor	72	9	18
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	74	3	23
V. Universiteti i Elbasanit	69	18	11
VI. Universiteti i Shkodrës	81	7	10
VII. Universiteti i Vlorës	74	15	10
TOTALI	81	9	10

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.7 Mënyra për të eliminuar mungesat në rast se një student ka më tepër nga sa parashikohet në rregullore

Mbi 50 % e studentëve të intervistuar mendon se nuk ke mundësi të regjistrohesh dot kur ke mbushur numrin maksimal të mungesave. Nga ana tjetër 26 % e studentëve mendojnë se me sekretarinë mund të gjendet një mënyrë regjistrimi në provim, apo justifikim i mungesave, ndërsa vetëm 13 % mendojnë se duke paguar nën dorë mund të shlyejnë mungesat.

Nga përgjigjet rezulton se në universitete të veçanta shifrat mesatare të lartpërmendura janë më të theksuara. Kjo duket në Akademinë e Arteve dhe Institutin e Fiskulturës ku rreth 40 % e studentevë mendojnë se mund ta rregullojnë këtë problem nëpërmjet sekretarisë, po këtë mendim kanë 31 % e studentëve të Politeknikut, 30 % e studentëve të Universitetit të Shkodrës. Për rreth 23 % e studentëve në Elbasan dhe 19 % e studentëve në Shkodër (shiko tabelen 7) mendon se dhënia e parave nën dorë është mënyra më efektive për shlyerjen e mungesave që i pengojnë hyrjen në provim. Të dy grupet e studentëve që përmendin si mënyrën e regjistrimit me anë të sekretarisë dhe atë të pagesës nën dorë megjithëse nuk përbëjnë shumicën (të dyja së bashku përbëjnë vetëm 39 % të të intervistuarve) përsëri ato përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm studentësh pjesë të kësaj skeme sigurisht jo transparente.



<i>Në % ndaj totalit</i>	<i>Gjen mënyrë rregjistrimi me sekretarinë</i>	<i>Me pagesë nën dorë</i>	<i>Nuk rregjistrohesh dot</i>	<i>Refuzon përgjigje</i>
I. Universiteti i Tiranës	23	10	59	8
II. Universiteti Politeknik	31	8	58	3
III. Univeriteti Bujqësor	28	13	54	5
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti I Fiskulturës	39	10	43	8
V. Universiteti i Elbasanit	21	23	55	1
VI. Universiteti i Shkodrës	27	19	50	4
VII. Universiteti i Vlorës	30	17	52	1
TOTALI	26	13	55	6


Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.8 Dhënia e provimit pas datës së fiksuar


Për këtë pyetje 68 % e studentëve të intervistuar përgjigjen negativisht, se nuk ka mundësi të jepet provimi pas datës së fiksuar kundrejt 32 % që përgjigjen pozitivisht.

Në universitetet e Tiranës, Shkodrës dhe Politeknik shumica e studentëve mendon se nuk mundet të japësh provime jashtë sezonit të tyre, me përkatësisht 76 %, 72 % dhe 71 % të tyre (shiko tabelën 8). Studentët e Universitetit të Elbasanit në masën 47 % që përbën dhe shifrën më të ulët, theksojnë pamundësinë e dhënies së provimit ndërsa pjesa më e madhe me 53% e pohojnë këtë fakt.

Duke u thelluar në këtë pyetje dhe duke ju referuar figurës 8/1, rezultojnë se 44 % e studentëve që i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje, mendojnë se provimi mund të shtyhet me paraqitjen e raportit mjekësor, 21 % e tyre mendojnë se ka mundësi të rregullohet nëpërmjet sekretarisë dhe 35% e tyre mendojnë se duke i dhënë para pedagogut mund të shtyhet afati i dhënies së provimit. Nga tabela 8/1 shikohet se në Univesitetin e Tiranës mënyra më e përdorshme për dhënien e provimit pas datës së caktuar është nëpërmjet pagesës ndaj pedagogut me 38 %. Për përgjigjet e rregullon me sekretarinë, Universiteti Politeknik përfaqësohet me vlerën më të madhe me 33 %. Paraqitja e raportit duke qënë dhe mënyra më e përdorshme nga studentët kap vlera të larta në të gjitha Universitetet e vëndit por të intervistuarit në Akademinë e Arteve dhe Institutin e Fiskulturës e përmëndin në masën 65 %.



Në % ndaj totalit	Jo	Po
I. Universiteti i Tiranës	76	24
II. Universiteti Politeknik	71	29
III. Univeriteti Bujqësor	54	46
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	52	48
V.Universiteti i Elbasanit	47	53
VI.Universiteti i Shkodrës	72	28
VII.Universiteti i Vlorës	67	33
TOTALI	68	32




Në % ndaj totalit të përgjigjeve pozitive	Paraqet raport	E rregullon me sekretarine	I jep para pedagogut
I. Universiteti i Tiranës	37	25	38
II. Universiteti Politeknik	44	33	22
III. Univeriteti Bujqësor	47	22	31
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	65	19	15
V.Universiteti i Elbasanit	58	7	35
VI.Universiteti i Shkodres	40	32	28
VII.Universiteti i Vlores	45	19	36
TOTALI	44	21	35

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.9 Mënyra e zgjedhur për të kaluar provimet.

Me këtë pyetje të drejtpërdrejtë rreth 78 % e studentëve përgjigjen se provimet do t'i kalojnë me zotësinë e tyre, 12 % e tyre shprehen se do të përdorin paratë ose njohjet dhe 10 % nuk e

kanë të qartë se si do të veprojnë. Kjo tregon se shumica e studentëve janë të ndërgjegjshëm se mënyra më e mirë për të kaluar provimin është nëpërmjet përgatitjes. Përgjigjet e studentëve që kanë zgjedhur alternativën me zotësi arrijnë shifrën më të lartë me 88% në Universitetin e Tiranës. Alternativa e parë dhe e dytë, pra me para dhe me njohje janë më pak të përzgjedhurat, ku vlerat më të larta shënohen për Universitetin Bujqësor, Akademinë e Arteve dhe Institutin e Fiskulturës. Sigurisht në këto përgjigje mund të konstatohet subjektivizmi në zgjedhje e studentëve. Për t'u theksuar këtu është se gati 10 % e studentëve në total nuk dinë ti përgjigjen kësaj pyetjeje duke hezituuar të japin përgjigjen e saktë. Sërish në Universitetin e Elbasanit rreth 18 % nuk prononohen. Kjo krijon idenë se për shumë studentë kemi alternimin e zgjedhjeve të mëposhtme. Një student në shumë raste e kalon një provim me zotësi e në raste të tjera përdor njohjet ose pagesën.



Në % ndaj totalit	Me para	Me njohje	Me zotësi	Nuk e di
I. Universiteti i Tiranës	3	6	88	3
II. Universiteti Politeknik	7	12	67	14
III. Univeriteti Bujqësor	9	8	69	15
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	1	15	67	16
V. Universiteti i Elbasanit	7	12	63	18
VI. Universiteti i Shkodrës	3	7	77	13
VII. Universiteti i Vlorës	7	5	81	7
TOTALI	4	8	78	10

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim


2.10 Pagesa mesatare për të kaluar provimin

Nga parqitja e figurës së mëposhtme 65 % e studentëve pretendojnë se nuk e dinë se sa paguhet për të marrë një provim, 17 % e tyre deklarojnë se e dinë këtë shumë dhe 18 % e tyre refuzon përgjigjen duke e konsideruar si pyetje delikate për ta, që mund t'u kushtojë probleme me pedagogun dhe nga frika heziton përgjigjen.

Në tabelën 10 shikohet se 30 % e studentëve në Universitetin e Elbasanit e dinë shumën që paguhet për provim ndërsa po 29 % refuzojnë përgjigje që evidenton qartë shkallën e lartë të korrupsionit të pedagogëve në këtë Universitet. Studentët e Universitetit të Tiranës deklarojnë vetëm në masën 10 % (shifra më e ulët) shumën e paguar për provim.

Në bazë të përgjigjeve të pjesës së studentëve që e deklarojnë shumën e paguar për provim paraqitet një klasifikim i Universiteteve dhe pagesave përkatëse. Pagesa në lekë për provim varion mesatarisht nga rreth 10 000 lekë në Universitetet në rrethe në 30 500 lekë në Universitetin e Tiranës. Edhe Universiteti Bujqësor, Politeknik, Arteve dhe Fiskulturës

shënojnë shifra të konsiderueshme të pagesës në lekë për provim kundrejt Universiteteve në rrethe.



Në % ndaj totalit	Nuk e di	Po e di	Refuzon pergjigje
I. Universiteti i Tiranës	76	10	14
II. Universiteti Politeknik	58	28	14
III. Univeriteti Bujqësor	67	13	20
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	72	10	18
V.Universiteti i Elbasanit	41	30	29
VI.Universiteti i Shkodrës	56	21	23
VII.Universiteti i Vlorës	59	26	15
TOTALI	65	17	18


Universitetet	Paguar mesatarisht në Lekë
I. Universiteti i Tiranës	30597
II. Universiteti Politeknik	21667
III. Univeriteti Bujqësor	15500
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	20000
V.Universiteti i Elbasanit	9417
VI.Universiteti i Shkodrës	10217
VII.Universiteti i Vlorës	9821

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.11 Faktorët nga të cilët varet pagesa për të kaluar provimin.

Në lidhje me pyetjen se nga cilët faktorë varet pagesa për të kaluar provimin, 46 % e studentëve mendojnë se vështirësia e lëndës është kusht bazë për vlerësimin e pagesës. Në totalin e studentëve 35 % mendojnë se tarifa vendoset nga pedagogu dhe 19 % e studentëve pretendojnë për rritje note me pagesë.

Në Universitetin e Elbasanit 55 % e studentëve mendojnë se pedagogu vendos tarifën, gjithashtu shifër e konsiderueshme është dhe në Universitetin e Tiranës ku 37 % e studentëve e pohojnë këtë fakt. Studentët e universitetit Politeknik në masën 64 % theksojnë se është vështirësia e lëndës ajo që ndikon në pagesën në lekë për provim. Një shifër jo e ulët, prej 57 % e përgjigjeve është në Universitetin e Shkodrës. Pretendimi për notën është përmendur nga 36 % e studentëve të Akademisë së Arteve dhe Instituti i Fiskulturës.



Në % ndaj totalit	Tarifa që vendos pedagogu	Veshtirësia e lëndës	Pretendimi për notën
I. Universiteti i Tiranës	37	44	19
II. Universiteti Politeknik	31	64	5
III. Univeriteti Bujqësor	29	52	19
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	24	40	36
V. Universiteti i Elbasanit	55	37	8
VI. Universiteti i Shkodrës	17	57	26
VII. Universiteti i Vlorës	29	53	18
TOTALI	35	46	19

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.12 Mesatarja e pedagogëve që imponojnë blerjen e librit të tij sipas Universiteteve.

Mesatarisht për një vit shkollor studentët zhvillojnë afërsisht 9 lëndë. Nga përgjigjet e kësaj pyetje rezultoi se studentët në total detyrohen mesatarisht nga 4 pedagogë për të blerë librat. Mesataren më të lartë të pedagogëve që imponojnë blerjen e librit të vet e gjejmë në Universitetin e Elbasanit dhe atë Bujqësor me 5 pedagogë. Vlera e shënuar më shpesh për këtë çështje është vlera mesatare 3. Në Universitetin e Tiranës mesatarja e pedagogëve që imponojnë blerjen e librit të tij përputhet me mesataren në total, gjithsej 4.

Tabela 12: Mesatarja e pedagogëve që imponojnë blerjen e librit të tij.


Universitetet	Mesatare
I. Universiteti i Tiranës	4
II. Universiteti Politeknik	3
III. Univeriteti Bujqësor	5
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	3
V. Universiteti i Elbasanit	5
VI. Universiteti i Shkodrës	3
VII. Universiteti i Vlorës	3
TOTALI	4

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.13 Sa të gatshëm janë studentët për të paguar për fakultetin që duan.

Përgjigjet e studentëve për këtë pyetje të drejtpërdrejtë tregojnë se vetëm 36 % e tyre janë të gatshëm të paguajnë dhe 62 % e tyre që nuk janë të gatshëm të paguajnë për degën që duan.

Shumë interesante paraqitet tabela 12 mbi preferencat e shfaqura nga studentët në degë të ndryshme për pagesën kundrejt Fakultetit që ata duan. Studentët e Akademisë së Arteve dhe Institutit të Fiskulturës u shprehën më të gatshmit për të paguar me gjithsej 59 % e tyre. Në UB janë të gatshëm të paguajnë 47 % e tyre, ndërsa nga Universitetet në rrethe në atë të Shkodrës 44 % e studentëve preferojnë të paguajnë për pranimin në fakultetin që duan. Gjithsesi përgjigjet e studentëve janë në përqindje më të larta për zgjedhjen jo kundrejt pagesës. Kështu në Vlorë 73 % e studentëve dhe në Elbasan 70 % e tyre nuk do të paguanin për t'u pranuar në fakultetin që ata pëlqejnë.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	32	67	1
II. Universiteti Politeknik	43	57	0
III. Univeriteti Bujqësor	47	53	0
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	59	41	0
V. Universiteti i Elbasanit	30	70	0
VI. Universiteti i Shkodrës	44	55	1
VII. Universiteti i Vlorës	25	73	3
TOTALI	36	62	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.14 Studentë që janë kërkuar direkt apo indirekt (seksualisht) nga pedagogu për të kaluar provimin

Në këtë nënçështje pavarësisht se pyetja është direkte duhen patur rezerva për përgjigjen dhe për këtë arsye ne jemi mundur ta rivlerësojmë këtë pyetje me pyetjen pasardhëse. Rreth 92 % e studentëve përgjigjen se nuk janë kërkuar nga pedagogu, vetëm 6 % e tyre e pohojnë një fakt të tillë dhe vetëm 2 % hezitojnë të përgjigjen për këtë pyetje.

Për sa i përket vlerësimit të kësaj pyetje sipas universiteteve, 12 % e studentëve në Bujqësor dhe 10 % e atyre në Akademinë e Arteve dhe Fiskulturës pohojnë faktin se janë kërkuar seksualisht nga pedagogët për të kaluar provimin.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	5	94	1
II. Universiteti Politeknik	5	95	0
III. Univeriteti Bujqësor	12	87	1
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	10	89	2
V. Universiteti i Elbasanit	8	93	0
VI. Universiteti i Shkodrës	6	92	2
VII. Universiteti i Vlorës	5	94	1
TOTALI	6	92	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

Figura 15 paraqet rastet në përqindje të abuzimit seksualisht me studentët. Rreth 53 % e studentëve pohojnë se kanë dëgjuar raste të tilla, 45 % e totalit të tyre pohojnë se nuk kanë dijeni dhe 2 % heziton të përgjigjet. Pra në analiza të tjera të rëndësishme duhet mbajtur parasysh ky fakt që në pyetjen 14 tepër të drejtpërdrejtë vetëm 6 % e studentëve pohojnë se janë kërkuar seksualisht nga pedagogu ndërsa në pyetjen e përgjithshme (Pyetja 15) mbi 53 % e tyre e pohojnë faktin e pyetjes 14.

Analiza e njëjtë në nivel universitetesh na tregon se 74 % e studentëve në Universitetin e Elbasanit e konfirmojnë faktin e mësipërm. Gjithashtu dhe në pyetjen e drejtpërdrejtë të mësipërme, rreth 8 % e studentëve në Elbasan pohojnë se ishin kërkuar seksualisht nga pedagogu. Në Universitetin e Shkodrës vetëm 40 % e studentëve kanë dëgjuar raste të tilla në auditorët studentore, ndërsa gati 58 % e tyre nuk e konfirmojnë faktin e sipërpërmendur.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	54	45	1
II. Universiteti Politeknik	63	37	0
III. Univeriteti Bujqësor	49	50	1
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	41	59	0
V.Universiteti i Elbasanit	74	25	1
VI.Universiteti i Shkodrës	40	58	3
VII.Universiteti i Vlorës	50	49	1
TOTALI	53	45	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.15 Dhurata apo favore që kërkojnë pedagogët nga prindërit e studentëve

Pyetjes a kërkojnë pedagogët dhurata apo favore nga prindërit tuaj, 72 % e studentëve shprehën se nuk u janë kërkuar nga pedagogët dhurata ose favore, 25 % të tyre pohojnë se u janë kërkuar dhurata apo favore, 3 % heziton të japë përgjigje.

Në universitetin e Elbasanit 40 % e studentëve pohojnë se kërkohen dhurata, favore po ashtu në Universitetin Politeknik dhe Vlorë 32 % e studentëve e pohojnë dhe 30 % e studentëve të Universitetit Bujqësor. Përgjithësisht ndaj totalit të përgjigjeve në lidhje me këtë pyetje shumica e përgjigjeve konfirmojnë të kundërtën pra se nuk kërkohen as dhurata as favore nga prindërit e studentëve. Kështu 79% dhe 78% në Universitetin e Shkodrës dhe Tiranës i thonë jo kësaj pyetjeje.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	20	78	2
II. Universiteti Politeknik	32	66	2
III. Univeriteti Bujqësor	30	67	3
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	20	77	3
V.Universiteti i Elbasanit	40	58	2
VI.Universiteti i Shkodrës	17	79	4
VII.Universiteti i Vlorës	32	68	1
TOTALI	25	72	3

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.16 Mënyra e sigurimit të dhomës në konvikt

Kjo pyetje është adresuar në lidhje me korrupsionin në administratën e Drejtorisë së Konvikteve dhe universiteteve që fasilton kushtet e studentëve të ardhur nga rrethe të tjera. Vetëm 34 % e studentëve pohojnë se janë akomoduar konform rregullave, 31 % e tyre pohojnë se kanë paguar nën dorë për të siguruar akomodimin në shtëpitë e studentit, 14 % e studentëve pohojnë se janë rregulluar me miqësi në strehimet studentore shtetërore dhe 21 % e studentëve nuk përgjigjen pasi mendojnë se janë të rrezikur për më vonë me anë të përgjigjes së anketimit tonë ose nuk nuk janë student të ardhur nga rrethet.

Universitetet në Tiranë si UT, Universiteti Bujqësor, Politekniku e kanë më të lartë numrin e përgjigjeve të studentëve konviktorë që pohojnë se është me pagesë nën dorë mënyra e përdorur për t'u akomoduar në konvikte, pasi duket se kërkesa për strehim është më e lartë në kryeqytet. Në universitetin e Elbasanit dhe të Shkodrës pagesa nën dorë përmendet nga 36 % e të intervistuarve ndërsa sigurimi i dhomave për studentët me anë të miqësisë thuhet nga përkatësisht 14 % dhe 18 % e studentëve.



Në % ndaj totalit	Konform rregullave	Me pagese nën dorë	Me miqësi	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	40	37	14	9
II. Universiteti Politeknik	34	40	14	12
III. Univeriteti Bujqësor	45	24	12	20
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	21	34	16	28
V.Universiteti i Elbasanit	35	36	14	15
VI.Universiteti i Shkodrës	25	36	18	20
VII.Universiteti i Vlorës	38	18	15	29
TOTALI	34	31	14	21


Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.17 A kanë privilegje studentët e zgjedhur në forumet e fakultetit

Në figurën e mëposhtme (figura 18) 47 % e studentëve përgjigjen se nuk dine gjë në lidhje me privilegjet ose jo që mund të gëzojnë studentët e zgjedhur në forumet e fakultetit. Në raport me totalin, 35 % e studentëve mendojnë se studentët e zgjedhur në forume gëzojnë privilegje ndërsa 16 % e studentëve mendojnë të kundërtën.

Faktin se studentët e zgjedhur në forume kanë privilegje veçanërisht e pohojnë studentët e Universitetit të Elbasanit me rreth 45 % të tyre, ata të Universitetit Bujqësor me 41 % dhe i Tiranës me 33 %. Të pakta janë vlerat në përqindje të studentëve që i janë përgjigjur

jo, në Universitetet në rrethe. Vlera më e madhe në përqindje është 28 % e dhënë nga studentët e Universitetin Politeknik.



Në % ndaj totalit	Po	Jo	Nuk e di	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	33	13	53	1
II. Universiteti Politeknik	28	28	45	0
III. Univeriteti Bujqësor	41	17	39	3
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	31	23	44	2
V.Universiteti i Elbasanit	45	17	36	2
VI.Universiteti i Shkodrës	36	13	48	3
VII.Universiteti i Vlorës	32	18	46	4
TOTALI	35	16	47	2


Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.18 Perceptimi i korrupsionit për pedagogët dhe dekanatin

Jemi munduar të vlerësojmë sipas shkallës së korrupsionit vlerësimin e përgjigjes, duke e ndarë atë në pedagogë shumë të korruptuar, të korruptuar, pak të korruptuar, jo të korruptuar. Vihet re se në total 61 % e studentëve identifikojnë se pedagogët e tyre janë shumë korruptuar dhe të korruptuar, shifër kjo me vlerë tepër të lartë dhe 8 % e studentëve mendojnë se pedagogët e tyre nuk janë të korruptuar. Në raport me totalin 29 % e studentëve e pranojnë që pedagogët janë të korruptuar pak.

Në nivel universitetesh është sërish ai i Elbasanit ku gati 80 % deklarojnë se pedagogët janë shumë të korruptuar ose të korruptuar. Ndërsa Universiteti i Shkodrës jep vlerën më të ulët në përqindje me 47 % të studentëve që flasin për korrupsion në radhët e pedagogëve.

Nëpërmjet kësaj pyetje informacioni që nxirret është tepër shqetësues, pasi tregon jo vetëm masën e lartë të përhapjes së korrupsionit, por edhe besueshmërinë e ulët që ka ky brez studentësh tek pedagogët apo tek e ardhmja e tyre.




Në % ndaj totalit	Shume të korruptuar	Të korruptuar	Pak të korruptuar	Jo të korruptuar	Heziton përgjigje
I. Universiteti i Tiranës	17	45	31	6	1
II. Universiteti Politeknik	15	49	26	9	0
III. Univeriteti Bujqësor	24	36	28	9	4
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	20	26	38	15	2
V.Universiteti i Elbasanit	38	43	18	2	1
VI.Universiteti i Shkodrës	20	27	35	16	2
VII.Universiteti i Vlorës	20	39	24	12	5
TOTALI	21	40	29	8	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

Për vlerësimin e kësaj pyetjeje jemi përpjekur të bëjmë ndarjen në nivele të korrupsionit në, shumë të korruptuar, të korruptuar, pak të korruptuar, jo të korruptuar. Nga përgjigjet e 30 % të studentëve del se administrata është vlerësuar si e korruptuar, 29 % e tyre mendojnë se është pak e korruptuar dhe 18% e tyre mendojnë se administrata është shumë e korruptuar. Vetëm 17 % e studentëve mendon se administrata nuk është e korruptuar. Dhe 6% e studentëve heziton të përgjigjet.

Nëse do të analizonim këtë pyetje në nivel universitetesh në rrethe por dhe Tiranë do të shihnim se 64 % e studentëve në Elbasan mendojnë se Administrata e Dekanatit është shumë dhe e korruptuar. Duke u nisur edhe nga nënçështja e mësipërme duket se në këtë Universitet shkalla e transparencës është më e ulët se në të gjithë universitetet e tjerë të marrë në analizë. Ndërsa në Universitetin e Shkodrës sërish mund të flasim për një shkallën më të ulët të korrupsionit në Administratë me vetëm 31 % të studentëve.




<i>Në % ndaj totalit</i>	<i>Shume të korruptuar</i>	<i>Të korruptuar</i>	<i>Pak të korruptuar</i>	<i>Jo të korruptuar</i>	<i>Heziton përgjigje</i>
I. Universiteti i Tiranës	18	34	32	12	4
II. Universiteti Politeknik	15	35	23	23	3
III. Univeriteti Bujqësor	12	25	43	16	4
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	21	21	21	33	3
V. Universiteti i Elbasanit	28	36	19	13	3
VI. Universiteti i Shkodrës	11	20	26	33	9
VII. Universiteti i Vlorës	21	30	29	15	4
TOTALI	18	30	29	17	6

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.19 Shkalla e informacionit të studentëve mbi forumet studentore

Me anë të kësaj pyetje evidentohet informacioni që studentët kanë në lidhje me forumet e tyre të ndryshme si dhe puna e forumeve për t'u afruar tek studentet. Rezulton se 86 % e studentëve nuk njohin ndonjë forum, gjë që tregon për shkallën e ulët të punës dhe efektivitetit të këtyre organizmave. Vetëm 14 % e studentëve pohojnë se i njohin forumet e tyre.

Në Universitetet si ai i Elbasanit, Bujqësor dhe Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës forumet pothuaj se nuk njihen fare nga studentët duke marrë vlera të tilla në përqindje si 97 %, 96 % dhe 95 %. Studentët e Universitetit të Shkodrës përbëjnë dhe kontigjentin më të madh të studentëve me 17 %, që kanë informacion mbi ekzistencën e forumeve studentore që mbrojnë të drejtat e tyre.



Në % ndaj totalit	Jo	Po
I. Universiteti i Tiranës	85	15
II. Universiteti Politeknik	88	12
III. Univeriteti Bujqësor	96	4
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	95	5
V.Universiteti i Elbasanit	97	3
VI.Universiteti i Shkodrës	83	17
VII.Universiteti i Vlorës	87	13
TOTALI	86	14


Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.20 Niveli i informimit që kanë studentët lidhur me hedhjen në gjyq ose jo të institucionit shkollor ose pedagogut.

Rastet kur studentët kanë hedhur në gjyq ose pedagogun ose institucionin shkollor u konfirmuan nga 18 % e studentëve, rreth 30 % pohojnë të kundërtën dhe 52 % e studentëve shprehen se nuk dinë gjë për këtë pyetje.

Numri më i madh i studentëve të mirëinformuar për rastet kur studentë kanë hedhur në gjyq pedagogun ose institucionin shkollor ku bëjnë pjesë, është në Universitetin e Elbasanit me 25 %, ndërsa studentët me shkallën më të ulët të informimit lidhur me këtë fakt e gjejmë në qytetin e Shkodrës me vetëm 8 % të të intervistuarve. Në Universitetin e Tiranës kemi një vlerë jo shumë të ulët në krahsim me Universitetet e tjerë me 22 % e studentëve që kanë dijeni në lidhje me këtë çështje.

Nga kjo analize del qartë që studentet janë të painformuar për çështje të ndryshme tepër të rëndësishme të lidhura me korrupsionin dhe transparencën e institucioneve drejtuese të Universiteteve.




Në % ndaj totalit	Jo	Po
I. Universiteti i Tiranës	85	15
II. Universiteti Politeknik	88	12
III. Univeriteti Bujqësor	96	4
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	95	5
V.Universiteti i Elbasanit	97	3
VI.Universiteti i Shkodrës	83	17
VII.Universiteti i Vlorës	87	13
TOTALI	86	14

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.21 Mënyrat e minimizimit të korrupsioni

Studentëve u janë hedhur disa alternativa të mundshme për të luftuar korrupsionin dhe ata nga eksperiencia e tyre e deritanishme janë të lirë të sugjerojnë dhe të japin alternativat e tyre, të cilat ata mendojnë si më të mira. Alternativat përmbledhen në: fushatën antikorrupsion, denoncimi i korrupsionit rast pas rasti, pjesmarrja aktive nëpër forume dhe metoda të tjera që vetë studentët mund të sugjerojnë. Të pyetur rreth këtyre mundësive për minimizimin e korrupsionit, 66 % e studentëve mendojnë se mënyra më efiçake e luftës së korrupsionit është denoncimi i tij rast pas rasti, 17 % mendojnë se zhvillimi me fushatë antikorrupsion është më efiças dhe 12 % e studentëve mendojnë se me pjesmarrjen aktive nëpër forume do të arrihet minimizimi i korrupsionit. Studentët nuk kanë qenë në gjendje të japin ndonjë metodë tjetër alternative për luftën e korrupsionit.

Në nivel Universitetesh 72 % e studentëve në Universitetin e Tiranës dhe 71 % e tyre në atë të Elbasanit mendojnë se denoncimi rast pas rasti do të ishte dhe metoda më efiçakte në funksion të minimizimit të korrupsionit.



Në % ndaj totalit	Me fushatë antikorrupsion	Denoncim rast pas rasti	Pjesmarrje aktive në forume	Të tjera
I. Universiteti i Tiranës	16	72	8	2
II. Universiteti Politeknik	26	60	14	0
III. Univeriteti Bujqësor	16	59	18	0
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	21	59	10	2
V. Universiteti i Elbasanit	22	71	7	0
VI. Universiteti i Shkodrës	20	51	26	0
VII. Universiteti i Vlorës	11	73	12	0
TOTALI	17	66	12	1


Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.22 Ndikimi pagave të pedagogëve ne nivelin e korrupsionit

Interesant në analizën e kësaj pyetjeje është fakti se përqindja e studentëve që mendojnë se shkak influencues në korrupsion është paga e ulët e pedagogëve, është e njëjtë në vlerë me atë të studentëve të cilët mendojnë të kundërtën gjithsej 39 %. Studentët që nuk janë në gjendje të vlerësojnë këtë faktor si burim korrupsioni janë 20 %.

Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës vlerësojnë pagat e ulëta të pedagogëve si arsye direkte që influencen në korrupsion me 57 % të përgjigjeve i ndjekur nga Universiteti

Politeknik me 48 %. Rreth 45 % e studentëve të Elbasnit nuk besojnë në idenë se janë pagat e ulëta ato që bëhen burim korrupsioni.




Në % ndaj totalit	Po	Jo	Nuk e di	Heziton pergjigje
I. Universiteti i Tiranës	39	43	17	1
II. Universiteti Politeknik	48	32	18	2
III. Univeriteti Bujqësor	37	38	20	5
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti iFiskulturës	57	23	16	3
V.Universiteti i Elbasanit	28	45	27	0
VI.Universiteti i Shkodrës	42	31	26	0
VII.Universiteti i Vlorës	33	44	22	1
TOTALI	39	39	20	2

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

2.23 Idhujt e studentëve

Në këtë nënçështje ku është paraqitur një shpërndarje e studentëve sipas idhullit që ata kanë nga figura 25 shikohet se, rreth 20 % e studentëve nuk kanë idhull, 37 % kanë prindërit, 13 % figurat politike, 10 % artistët. Nga këto përgjigje del qartë se studentët nuk kanë figura tipike qëndrore që ti motivojnë të ecin përpara si në shkencë apo të tjera veprimtari, ju mungon vizioni i qartë perspektiv, ata mbeten brënda kuadrin të familjes duke patur idhull prindërit gjë që për subjektin për të cilin janë pyetur është përgjigje jo me shumë vlerë.

Në nivel universitetsh paraqitet gati e njëjta situatë në shpërndarjen në përqindje ku gati opsioni më i zgjedhur është sërish prindi por që në Universitetet në rrethe si Elbasan, Shkodër, Vlorë kjo përqindje është më e vogël se Universitetet që janë në Tiranë. Vlerën më të ulët të zgjedhjes së këtij opsioni e gjejmë sigurisht në Akademinë e Arteve me 15 % të përgjigjeve kundrejt 33 % të përgjigjeve që i referohen opsionit artist.



Në % ndaj totalit	Jo	Figurë politike	Prindin tuaj	Shkencëtar	Pedagog	Artist	Tjetër
I. Universiteti i Tiranës	21	12	40	4	10	6	7
II. Universiteti Politeknik	9	5	45	5	15	9	12
III. Univeriteti Bujqësor	11	11	45	7	7	17	4
IV. Akademia e Arteve dhe Instituti i Fiskulturës	8	20	15	0	11	33	13
V. Universiteti i Elbasanit	17	14	31	2	15	18	5
VI. Universiteti i Shkodrës	25	12	37	3	14	5	4
VII. Universiteti i Vlorës	20	15	31	3	21	9	2
TOTALI	19	13	37	3	12	10	6

Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim

Kapitulli III: Konkluzione

3.1 Konkluzione

Pasi analizuam të gjitha përgjigjet e pyetjeve në lidhje me transparencën në arsimin e lartë, perceptimin e korrupsionit dhe zbatueshmërinë e rregulloreve të univesiteteve mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- Nga tërësia e procedurave të pranimit, problematika më e madhe është tek puna e komisionit të vlerësimit të provimeve të pranimit.
- Për të kaluar provimet në rrugë jo të ligjshme studentët përgjithësisht përdorin njohjen/miqësinë në mënyrë pothuajse të barabartë me pagesën me para në dorë (10-15 %).
- Rreth 8-10 % e studentëve janë kërkuar seksualisht direkt apo indirekt nga pedagogu për të kaluar provimin.
- Rreth 60 % e studentëve mendojnë se pedagogët janë të korruptuar dhe shumë të korruptuar, ndërsa për administratën e dekanatit kjo përqindje zbret në rreth 50 %.
- Forumet e studentëve njihen pak ose aspak nga studentët.
- Studentët ndajnë një mendim të ekuilibruar në lidhje me nivelin e pagave si burim korrupsioni (balanca është 0).
- Denoncimet rast pas rasti shikohet si forma më e mirë për të luftuar korrupsionin në shkollën e lartë, megjithëse një përqindje jo e vogël (17 %) mendojnë se edhe fushatat antikorrupsion janë një mjet i mundshëm.
- Pjesa më e madhe e studentëve të intervistuar (37 %) kanë prindin idhull të tyre.

TABELA 1: Shpërndarja e të intervistuarve sipas Universiteteve

Universitetet e Tiranës	672
Universiteti i Tiranës	470
Fakulteti Ekonomik	115
Fakulteti Histori-Filogji	60
Fakulteti i Gjuheve të Huaja	60
Fakulteti i Mjekësisë	84
Fakulteti i Shkencave Sociale	40
Fakulteti i Drejtësisë	56
Fakulteti Shkencave të Natyrës	55
Universiteti Politeknik	65
Universiteti Bujqësor	76
Akademia e Arteve	35
Instituti Fiskultures	26
Universiteti Elbasan	120
Fakulteti Shkencave Shoqërore	89
Fakulteti Mësuesisë	10
Fakulteti i Gjuheve të Huaja	20
Universiteti Shkoder	118
Fakulteti Shkencave të Natyrës	55
Fakulteti Shkencave Shoqërore	21
Fakulteti Ekonomik	7
Fakulteti Juridik	18
Fakulteti Mësuesisë	10
Fakulteti i Gjuheve të Huaja	7
Universiteti Vlorë	117
Fakulteti Tregëtisë	18
Fakulteti Shkencave të Natyrores	3
Fakulteti Infermierisë	13
Fakulteti Mësuesisë	39
Dep.Gjuhës angleze	44
Totali	1027

**Pyetesor mbi:
Transparençen per aresimin e larte**

Emri i Universitetit _____

Fakulteti/ Dega _____

Viti i studimit _____

Seksi: M F

1. A zbatohen rregullat e pranimit ne fakultetin qe ju keni zgjedhur?

1 Po 2 Jo

2 Si jane zbatuar procedurat e provimit te pranimit ne fakultetin tuaj?

1 Konform rregullave 2 Jane shkelur rregullat 3 Nuk e di

3 Si e konsideroni se ka qene puna e komisionit te vleresimit te provimit te pranimit?

1 Ka manipulime 2 Nuk ka manipulime 3 Heziton pergjigjen

4 A ka patur pranime jashte listes se shpallur te provimit te pranimit?

1 Po 2 Jo 3 Nuk e di

5 Sa para eshte paguar per t'u regjistruar jo konform rregullave ne kete fakultet (nga ty ose shoket e tu)?

1 Nuk e di 2 Po e di (shumen)____ 3 Refuzon pergjigjen

6. Si do te sigurosh pranimin/ hyrjen nga pedagogu ne provim?

1 Konform rregullave 2 Duke paguar 3 Me miqesi

7. Si vepron kur ke me shume mungesa ne semester nga parashikohet ne rregullore ?

1 Gjen menyre regjistrimi me sekretarine 2 Me pagese nen dore 3 Nuk regjistrohesh dot

8. A mund te japesh provimin edhe pas dates se fiksuar ?

1 Jo 2 Po, nese:

- ① Paraqet raport
- ② E rregullon me sekretarine
- ③ I jep para pedagogut

9. Si mendoni se do t'i kaloni provimet?

1 Me para 2 Me njohje 3 Me zotesi 4 Nuk e di

10. Mesatarisht sa para paguhet per te kaluar provimin?

1 Nuk e di 2 Po e di (shumen)____ 3 Refuzon pergjigjen

11. Nga cilet faktore varet pagesa per te kaluar provimin?

1 Tarifa qe ve pedagogu 2 Veshtiresia e lendes 3 Nga pretendimi per noten

12. Sa nga pedagoget e tu imponojne te blini librin i tij? _____

13. A jeni ju te gatshem te paguani per pranimin ne fakultetin qe doni?

1 Po 2 Jo

14. A jeni kerkuar direkt apo indirekt (seksualisht) nga pedagogu per te kaluar provimin?

1 Po 2 Jo

15. Po ne ambjentin tuaj studentor keni degjuar raste te tilla?

1 Po 2 Jo

16. A kerkojne pedagoget dhurata apo favore nga prinderit tuaj?

1 Po 2 Jo

17. Si e keni siguruar ne konvikt marrjen e dhomes?

1 Konform rregullave 2 Me pagese nen dore 3 Me miqesi

18. A kane privilegje studentet e zgjedhur ne forumet e fakultetit?

1 Po 2 Jo 3 Nuk e di

19. Sa te korruptuar jane pedagoget sipas mendimit tuaj?

1 Shume te korruptuar 2 Te korruptuar 3 Pak te korruptuar 4 Jo te korruptuar

20. Sa e korruptuar eshte Administrata e Dekanatit sipas mendimit tuaj?

1 Shume e korruptuar 2 E korruptuar 3 Pak e korruptuar 4 Jo e korruptuar

21. A njhni ndonje forum qe mbron te drejtat tuaja?

1 Jo 2 Po (cileso emrin) _____

22. A ka studente qe kane hedhur ne gjyq institucionin shkollor ose pedagogun?

1 Po 2 Jo 3 Nuk e di

23. Si mendohet se mund te minimizohet korrupsioni?

1 Me fushate antikorrupsion 2 Denoncim rast pas rasti 3 Pjesmarrja aktive ne forumet e universiteti

4 Te tjera, specifiko _____

24. A mendoni se pagat e ulta te pedagoqeve jane burim korrupsioni ?

1 Po 2 Jo 3 Nuk e di

25. A keni idhull ndonje (kryqezo 1 opsion dhe sheno emrin) _____

1 Figure politike _____ 3 Shkencetar _____ 5 Artist _____

2 Prindin tuaj _____ 4 Pedagog _____ 6 Tjeter, speci _____

